



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2023

Lënda: Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - prill 2023

KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Tiranë

Të nderuar anëtarë,

Në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 19, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, po ju parashtrojmë dokumentin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - prill 2023, miratuar me vendimin nr. 05 prot, datë 30.05.2023, të Mbledhjes së Grupit për Menaxhimin Strategjik.

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, është hartuar për shqyrtim dhe miratim nga Grup i Menaxhimit Strategjik, relacioni dhe formatet standarde, si pjesë e strukturës së raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar - prill 2023.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të menaxhimit financiar, monitorimit i kushtohet një vëmendje e veçantë si një nga 5 komponentët shumë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për 4-mujorin e parë të vitit 2023, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt sa i përket produkteve të përcaktuar dhe zërave të shpenzimeve, dhe planifikimit të buxhetit në PBA-në (2023-2025).

Në kërkesat buxhetore për vitin 2023, Kolegji i Posaçëm të Apelimit, ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, “Çështje të ankimuara/shqyrtuara” me një plan vjetor në masën 90 çështje. Gjatë periudhën janar - prill 2023, Kolegji ka marrë në shqyrtim 18 çështje me një realizim prej 20 %.

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në zbatim të ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023, janë përcaktuar në vlerën 207.664 mijë lekë. Plani për periudhën 4/mujore është **77.514 mijë lekë** dhe realizimi **59.251 mijë lekë** ose **76.4 %**.

Shpenzimet buxhetore sipas artikujve kryesore, paraqiten në tabelën në vijim.

000/lekë

Llogaria ekonomike	Emertimi	Plani vjetor 2023	Plani 4-mujor	Realizimi 4-mujor	% realizimit
6000000	Paga	166.100	64.350	51.210	79.6%
6010000	Kontribute për sigurimet shoqërore, shëndetsore	15.660	5.500	4.868	88.5%
6020000	Mallra dhe shërbime	22.540	4.300	3.016	70.1%
6060000	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1.364	1.364	157	11.5%
2310000	Investime Kapitale	2,000	2.000	0	0.0%
	Totali	207.664	77.514	59.251	76.4%

I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Buxheti për vitin 2023 në paga është **166.1 milionë lekë** dhe përbën 80 % të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në paga, për periudhën janar- prill 2023, është **64.3 milionë lekë** dhe realizimi **51.2 milionë lekë** ose 79.6 %.

Kjo vlerë përfshin pagat e punonjësve të strukturës organike prej 57 (pesëdhjetë) punonjës, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 35/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit” dhe pagat për 6 (katër) punonjës me kontratë të përkohshme përcaktuar në VKM-në nr. 56, datë 01.02.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023.

Gjatë kësaj periudhe llogaritja e pagave dhe sigurimeve shoqërore për gjyqtarët dhe këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, është kryer sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e pikës 5, të nenit 12 të ligjit 96/2016.

Niveli i realizimit të këtij zëri të shpenzimeve është ndikuar nga fakti që procedurat e rekrutimit për 3 (tre) këshilltarë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, nuk kanë përfunduar gjatë kësaj periudhe, si dhe nuk është përdorur fondi i detajuar për pagesën me 1 (një) pagë mujore, si vështirësi për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe nuk janë plotësuar vendet vakante për pozicionet specialist IT dhe specialist financë/buxheti, procedurat e rekrutimit për të cilat nuk kanë përfunduar gjatë kësaj periudhe.

Theksojmë së fondet buxhetore në shpenzime personeli janë të pamjaftueshme për mbulimin e nevojave të Kolegjit. Për këtë arsye me shkresën nr 179/1 prot., datë 09.02.2023, është kërkuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë shtesë në buxhet në vlerë totale **36.6 milion lekë**, si më poshtë:

- **10.5 milionë lekë**, në shpenzime personeli, të paplotësuara me buxhetin e miratuar me ligjin e buxhetit 84/2022 “Për buxhetin për vitin 2023”;

- **26.1 milionë lekë**, në shpenzime personeli për mbulimin e efektit financiar nga zbatimi i vendimit nr.35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, për vitin 2023.

Aktualisht ende nuk kemi një përgjigje lidhur me këtë kërkesë.

II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Buxheti i rishikuar për vitin 2023 në sigurime shoqërore dhe shëndetësore është **15.7 milionë lekë** dhe përbën 7.5 % të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në zërin sigurime shoqërore, për periudhën janar- prill 2023, është **5.5 milionë lekë** dhe realizimi **4.9 milionë lekë** ose 88.5 %. Fondi për sigurimin është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, dhe në

përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga, si rrjedhojë argumentet e nivelit të realizimit të fondit të pagave vlejné dhe për këtë zë.

III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihen një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale. Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2023, është **23.6 milionë lekë**, dhe përbën 11.4 % të buxhetit total vjetor.

Buxheti i rishikuar pas transferimit të fondit në vlerë 1,100 mijë lekë nga artikulli 602 ne artikullin 606, për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët e Kolegjit është **22.5 milion lekë**.

Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për periudhën janar- prill 2023, është **4.3 milionë lekë** dhe realizimi **3 milionë lekë** ose 70.1 %.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim:

MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	Realizimi viti 2023 (në lekë)
Shpenzime për energji elektrike	546.064
Shpenzime për furnizimin me ujë	16.668
Shërbime telefonie fikse	9.119
Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar	66.325
Shpenzime publikimi në shtyp për pozicionet vakante në institucion	93.600
Shpenzime qiraje për ambientet shtesë	476.000
Shpenzime udhëtimi dhe dieta për shërbim jashtë vendit	190.550
Shpenzime për blerje ujë të pijshëm për personelin dhe seancat gjyqësore	188.620
Shpenzime për kanceleri dhe letër	350.000
Shërbime telefonie celulare	156.236
Shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës	351.200
Shpenzime për tatime dhe taksa	99.000
Shpenzime për mirëmbajtjen e faqes zyrtare	40.000
Shërbime transporti (parkim+ larje për automjetin e institucionit)	207.600
Karburant për automjetin e institucionit)	225.648
TOTALI	3.016.630

Gjatë periudhës janar - prill 2023, janë shlyer detyrimet lidhur më shpenzimet për energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar), telefoni fikse, si dhe publikime në media të vendeve të shpallura vakante në institucion, për një vlerë totale 731.776 lekë.

Janë kryer shpenzime për pagesë e qirasë të ambienteve shtesë për nevojat e institucionit në vlerën 476.000 lekë, si edhe shpenzime për tatime dhe taksa në vlerën 99.000 lekë, që në pjesën më të madhe përbëhen nga pagesa e tatimit në burim për pagesën e qirasë.

Janë kryer shpenzime për telefoninë celulare ku përfshihen prokurimi i shërbimit për Kryetaren e Kolegjit, këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe drejtuesve të administratës si dhe kompensimi i gjyqtarëve, sipas kuotës mujore, përcaktuar me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, në vlerën 156.236 lekë.

Janë kryer shpenzime për një udhëtim pune të titullarit të institucionit në vlerën 190.550 lekë.

Janë kryer shpenzime për automjetin e institucionit duke përfshirë furnizimin me karburant, pastrimin dhe vend parkimin me vlerë totale 433.248 lekë.

Në realizimin e kësaj periudhe janë përfshirë shpenzime që i përkasin kontratave në vazhdim, për sigurimin e jetës dhe shëndetit, për punonjësit e rinj, për një vlerë totale 351.200 lekë.

Janë plotësuar nevojat e institucionit për materiale dhe shërbime të nevojshme gjatë aktivitetit të përditshëm të institucionit ku përfshihen shpenzime për kancelari, letër A4, materiale, furnizimi me ujë të pijshëm për personelin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore, në vlerën 538.620 lekë, si dhe mirëmbajtja e faqes zyrtare të institucionit në vlerën 40.000 lekë.

Në nivelin e realizimit për kategorinë mallra e shërbime, për këtë periudhë, ka ndikuar edhe fakti që janë ende në proces procedurat e prokurimit për blerjen e materialeve të pastrimit, si dhe shërbimit të mirëmbajtjes për serverët, kompjuterët dhe pajisjet e zyrës.

IV - Shpenzimet për Trans per Buxh. Fam. & Individ (llogaria ekonomike 606)

Buxheti i detajuar në këtë zë është në vlerën 1,364 mijë lekë dhe realizimi 157 mijë lekë ose 11.5%.

Në këtë grup përfshihet fondi i veçantë në vlerë 264 mijë lekë miratuar me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” si dhe fondi në vlerë 1,110 mijë lekë për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët e Kolegjit, transferuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 4290/1 prot., datë 09.03.2023, nga artikulli 602 “Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime” në artikullin 606.

Gjatë kësaj periudhe është kryer rimbursimi i shpenzimeve telefonike të gjyqtarëve sipas përcaktimit në VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publik”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

V. Investime kapitale (431)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2023 në investime është **2 milionë lekë** dhe përbën rreth 1 % të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në zërin investime, për periudhën janar-prill 2023, është **2 milionë** lekë dhe realizimi **0 (zero)**lekë ose 0 %.

Këto fonde janë parashikuar për plotësimin e nevojave për punonjësit shtesë të kërkuar në strukturën organike miratuar te miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 35/2022, si dhe nevoja të tjera të institucionit, për pajisje kompjuterike në vlerën 1.2 milion lekë dhe pajisje dhe mobilje zyre në vlerën 800 mijë lekë.

Ne muajin prill kane filluar dhe janë në përfundim, procedurat e prokurimit për plotësimin e nevojave për punonjësit shtesë në strukturë.

Bashkëlidhur lutem gjeni formatet standarde për raportimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar - prill 2023.

Duke ju falënderuar,